

Njoftim për përqendrim me të cilin Volvo Biznis Servisis Interneshenl AB nga Suedia dhe Reno s.a.s. nga Franca do të formojë një ndërmarrje plotësisht funksionale të përbashkët

(lënda nr. 08-154 i 2023)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ Nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 24.10.2023, në Komisionin e Mbrojtjes së Konkurrencës, është dorëzuar një njoftim për përqendrim me të cilin Volvo Biznis Servisis Interneshenl AB me një seli të regjistruar në Qarkun Vestra Getaland, 405 08 Geteborg, Suedi dhe Reno s.a.s me seli të regjistruar në 122-122 bis Avenija të General Leklerk, 92100 Bulonj-Bilankur, Francë do të formojë një ndërmarrje plotësisht funksionale të përbashkët për zhvillimin, prodhimin dhe shitjen e produkteve të automjeteve të reja të lehta tregtare (ALT) dhe shërbimeve logjistike ndihmëse.

- **Volvo Biznis Servisis Interneshenl AB** është një kompani prodhuese shumëkombëshe me seli në Geteborg, Suedi. Ajo është globalisht aktive në prodhimin dhe shitjen e kamionëve brenda dhe jashtë autostradës, autobusëve, pajisjeve të ndërtimit, motorëve detarë, motorëve industrialë jashtë rrugës dhe prodhimit të energjisë dhe motorëve të automjeteve në autostradë. Ndërsa kamionët e shitur nën markën Volvo përfshijnë vetëm kamionë të rëndë dhe të mesëm, gama e produkteve “Renault Trucks” shtrihet edhe tek ALT-të (prodhohen dhe shiten me licencë të Reno). Përndryshe, Volvo nuk zhvillon, prodhon ose shet ALT.

Volvo Biznis Servisis Interneshenl AB ka një ndërmarrje-bijë të themeluar në Maqedoninë e Veriut: **Volvo Makedonija VTC Shpknjp**, me seli në rrugën 112 nr. 2/14 Qojlija, Petrovec, Shkup, Maqedonia e Veriut. Aktivitetet e Volvo SMAK janë shërbime pas shitjes dhe punëtori.

-**Grupi Reno** kryesisht prodhon dhe shet automjete, pjesë dhe shërbime të lëvizshmërisë nën markat 'Reno', 'Daçia', 'Alplajn' dhe 'Mobilize'. Automjetet Reno përfshijnë ALT. Reno ka një aleancë strategjike me Nisan dhe Micubishi që i jep Reno kontrollin e vetëm mbi të dy grupet sipas rregullave të kontrollit të bashkimit.

Grupi Reno nuk ka një ndërmarrje-bijë të inkuorporuar në Maqedoninë e Veriut.

Transaksioni i propozuar ka të bëjë me tregun e prodhimit dhe furnizimit të ALT.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

25.10.2023

Shkup